



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

qNumri i lëndës: 2018:022049

Datë: 24.04.2019

Numri i dokumentit: 00289512

P. nr. 514/09

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. N. nga fsh. ... K. Gjakovë, për shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë nga neni 253 par.1-1 të KPK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Publike në Gjakovë, PP-nr.555/09 të datës 30.09.2009, në shqyrtimin gjyqësor, të mbajtur më datë **24.04.2019**, në prani të Prokurorit të shtetit Armend Zenelaj dhe të akuzuarit A. N., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A. N.** nga fsh. ... K Gjakovë ,tani me banim ne Prishtinë , Rr ” ...” , i biri i N. dhe i nënës M. e gjinisë N., data e lindjes ..., ka te kryer shkollim universitar, punëtor, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar ,shtetas i R. Kosovës , i pa martuar , me nr.ID ...

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse:

-me dt.03.02.2009 ,ne orët e pacaktuara me qellim qe vetit ti sjellë përfitim pasuror kundërligjor ,me qëllim vjedhje ka shkuar në zyrën e P. S. e cila gjendet ne Rr”...” ne Gjakovë ,dhe pasi me forcë ka hapur dritaren e podrumit ka vjedhur 1(një) printer te tipit “Samsung” dhe është larguar ne drejtim te paditur , duke i shakatar te dëmtuarit dem material në vlere 150 euro .

-me çka ka ndihmuar ne kryerjen e veprës penale të vjedhjes së rëndë nga neni 253 par.1pika 1 të KPK-së

Andaj Gjykata në bazë te nenit 4, 41, 49, 50, 51, 52, 73 neni 253 par.1-1të KPK-së dhe nenit 365 të KPP të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Dënim me burgim me kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muajve** , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit, në afatin prej **1(një) viti** ,nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale .

E dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që ti paguajnë shpenzimet procedurale të përcaktuara nga ana e gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej nga **30,00.-€**, në afat prej **15** ditësh, e kreyt këtë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Komunale në Gjakovë , ka ngritë Aktakuzën PP.nr.555/09 të 30.09. 2009, ndaj të akuzuarit A. N. nga fsh. ... K Gjakovë , për shkak të veprës penale vjedhje e rende nga 253/1.1 të KPK-së .

Gjykata kundër të akuzuarit A. N. ka lëshuar urdhëresë për shpalljen e letër rreshtimit P.nr. 514/09 me dt. 04.05.2011 ,me qene se i njëjti nuk ka marr pjesë në seancën e caktuar mbi konfirmimin e aktakuzës ndërsa nga st. policor me nr ref. INV/GJ/RD nr.125/11 të dt. 04.05.2011 jemi njoftuar se i akuzuari nuk gjendet në shtëpi ndodhet diku në Mal të Zi .

Me dt. 24.04.2019 i njëjti është shoqëruar nga st. policor në Gjakovë duke vepruar sipas urdhëresës për shpallje të letër rreshtimit, i njëjti u procedua dhe për të njëjtin do të tërhiqet urdhëresa për shpallje të letër rreshtimit.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 24.04.2019, përfaqësuesi i PTH-së në Gjakovë , Prokurori Armend Zenelaj , deklaroi mbetet në tërësi pranë aktakuzës .

I akuzuari A. N. , gjatë shqyrtimit fillestar me dt. 24.04.2019,deklaroi se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me parë pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, me qene se një gjendje e tillë është konstatuar ngase edhe në fazat e mëhershëm me rastin e marrjes në pyetje nga st. policor unë kam pranuar se të njëjtin e e kam marr me qellim të kryerjes se disa punëve për nevoja partiake e të cilën printer me pas e kam kthyer me dt. 10.11.2009.Marr parasysh këto rrethana si pranimi i fajësisë , kthimi i gjësendit për të cilën pretendohet se e kam vjedhur pasi që kam qene pjese e kësaj partie ,kam pasur çelësat e zyrës dhe kam menduar se kam të drejtë të shkojë dhe ta marr pa e ditur se jam duke kryer vepër penale, premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet me qene se që nga ajo kohë nuk kam kryer ndonjë vepër penale dhe do të jem edhe me i kujdesshëm të me shqiptojë një dënim me të butë.

Duke u deklaruar lidhur me fajësinë prokurori I shtetit Armend Zenelaj deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi që i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favorët juridike të pranimi të fajësisë, ky pranimi i fajësisë është bere me vetëdije të plote dhe pa presion dhe se pranimi i fajësisë është vërtetuar në tërësi gjendja e plote dhe e drejtë faktike në aktakuzë dhe shkresa të lendes, andaj i propozoi gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor , të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari A. N. : --me dt.03.02.2009 ,në orët e pacaktuara me qellim që veti të sjellë përfitim pasuror kundërligjor ,me qellim vjedhje ka shkuar në zyrën e P. S. e cila gjendet në Rr”...” në Gjakovë ,dhe pasi me forcë ka hapur dritaren e podrumit ka vjedhur 1(një) printer të tipit “Samsung” dhe është larguar në drejtim të paditur , duke i shakatar të dëmtuarit dem material në vlerë 150 euro .

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak të se cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është

bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë ,pranimi është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza ,ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarin ta shpalle fajtor dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarit ,gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit .Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, gjendjen e tij te dobët ekonomike ,pranimin e fajësisë , sjelljen korrekte në gjykim , kërkim falja nga e dëmtuara, kthimi I gjësendit , premtimin se një veprim i tillë nuk do te përsëritet, ,koha e kryerjes se veprës penale si dhe faktin se i njëjti më parë nuk ka qenë i dënuar nga ana e gjykatës . Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht duke ia vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatja prej **6 (gjashtë) muaj** , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti** nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale , do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari me bindje se në rastin konkret ky sanksion është adekuate me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit. Gjykata beson se me shqiptimin e sanksionit të tillë, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në dispozitën e nenit 41 të KPRK-ës, se kjo do të ndikoj tek i akuzuari që në të ardhmen të mos kryej vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marr komfor nenit 463 par. 2 të KPPK-së ,pasi te dhënat e mbledhura nuk paraqesin bazë te sigurt për gjykimin te plotë.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor bazohet ne dispozitat e nenit 450/1 dhe 2 nen par. 2.6 te KPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,

P. nr. 514/09 më datë 24.04.2019.

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

ËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë ,në afatin **15 ditësh** nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë .Ankesa ne kopje te mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:022049
Datë: 24.04.2019
Numri i dokumentit: 00289512